



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT
VLORË



Nr. 2230/1219/685 Regjistri
Data 30.05.2018

Nr. 240 Vendimi
Data 22.07.2020

V E N D I M
“Në Emër të Republikës”

Gjykata e Apelit Vlorë, e përbërë nga :

ILIBA BEZATI	Kryesuese
SOKOL NGRESI	Anetar
NAZMI TROKA	Anetar

Sot në datë 22.07.2020 mori në shqyrtim në shkallë të dytë, çështjen civile që i përket:

PADITËS: [REDACTED], i biri i [REDACTED], i dtl. [REDACTED] lindur dhe banues ne Fier, lagja [REDACTED], rruga [REDACTED], me shtetesi shqiptare.

I PADITUR: Shoqeria Albpetrol sh.a, Patos, e perfaqesuar ne gjykim nga juristi [REDACTED]

PERSON I TRETË: Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi, ne mungese.
Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Vlorë, përfaqësuar nga av. [REDACTED]

OBJEKTI: Konstatimi i faktit te diskriminimit te paditesit, per shkak te lidhjeve familjare ne formen e viktimizimit, e kryer nga ana e punedhenesit Albpetrol sh.a, Patos.

Ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe pasojave te ardhura, duke detyruar punedhenesin Albpetrol sh.a, Patos, te riktheje paditesin ne vendin e meparshem te punes ne pozicionin e juristit prane pales se paditur.

Detyrimin e punedhenesit Albpetrol sh.a, Patos te demshperbleje paditesin per demin pasuror dhe jopasuror te pesuar.

Detyrimin e punedhenesit Albpetrol sh.a, Patos te paguaje shpenzimet gjyqesore dhe ato te perfaqesimit me avokat.

BAZA LIGJORE: Nenet 17/2, 18, 33, 49 dhe 116 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise; neni 14 i Konventes Europiane per te Drejtat e Njeriut; nenet 31, 32/a, 153 dhe 154 te K.Pr.Civile; nenet 9, 10 dhe 10/1 te K.Punes; nenet 3, 7, 12, 13, 34, 36, 37 dhe 38 te ligjit nr. 10221, dt.04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi"; nenet 608, 625 dhe 640 te K.Civil; Vendimi Unifikues i Gjykates se Larte nr. 12, dt. 14.09.2007; Vendimi i Gjykates Kushtetuese nr.6, dt.17.02.2012.

Gjykata e Shkallës së Parë Fier, me vendimin Nr.546, date 20.04.2018 ka vendosur:

- Rrezimin e padise.
- Shpenzimet gjyqesore t'i ngarkohen paditesit.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim paditesi, me të cilin kërkon ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë, duke parashtruar shkaqet si më poshtë :

- Argumenti i parashkrimit të padise nuk qendron, sepse sipas vendimit me nr.516 të zgjidhjeve të marrëdhënieve të punës, perfundimi i këtyre marrëdhënieve është dt 22.11.2014.
- Në librezën e punës, në faqen 21 është bërë shënimi nga Albpetrol se, shkeputja e marrëdhënieve të punës është vertetuar gjyqesisht me vendim gjyqësor të formës së prere me vendimin nr. 1409(510), dt.20.04.2015 dhe aktet si zgjidhja e marrëdhënieve të punës, si dhe librezë e punës, paditesit i janë vënë zyrtarisht në dijeni, pas datës 15.01.2015, pasi ishte hedhur padia në proces.
- Paditesi i është drejtuar zyrtarisht me ankese KMD Tirane në dt.13.01.2015 dhe KMD Tirane është shprehur me vendimin me nr.164, dt.19.11.2015. Pra, komunikimi zyrtar dhe marrja zyrtarisht në dijeni e shkresave të Albpetrol sh.a. i janë bërë zyrtarisht me dije paditësit në vitin 2015, sepse marrja në dijeni është ajo e formës së kërkuar nga ligji pra, zyrtarisht dhe në mënyrë shkresore.
- Padia është depozituar me dt.09.11.2017 pra brenda 3 viteve të zgjidhjeve të marrëdhënieve të punës, si dhe brenda 3 viteve nga të gjitha shkresat dhe vendimet gjyqesore të përmendura me sipër dhe që janë pjesë e dosjes gjyqesore, sepse nuk ka asnjë akt të shkruar që i është vënë në dijeni në vitin 2014, cdo akt i është vënë në dispozicion në gjykatë në vitin 2015.
- Gjithashtu, gjykata ka qenë në kushtet e konfliktit, sepse gjyqtari I ceshtjes ka punësuar familjare të radhës së parë (motren) në Albpetrol sh.a Patos, pasi është pushuar familjarisht nga puna paditesi dhe gjithë familja e tij, pra Gjyqtari po gjykonte punëdhënësin e familjareve të tij, kundër paditesit [REDAKTUAR], në kundërshtim flagrant me nenin 72/5 të K.Pr.Civile. Fakti që gjyqtari u bë pale dhe avokat mbrojtës i "Albpetrol" sh.a., duke zhvilluar një gjyq fars, me një vendim të paarsyetuar, nuk ka pranuar të sillen provat e kërkuara nga paditesi, nuk pranoi depozitim provash, nuk pranoi si nderhyes dytesor babain e paditësit.
- Lidhur me vendimin e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës marrëdhëniet duhet të kishin përfunduar në 21.11.2014, por për muajt shtator-tetor-nëntor 2014 Albpetrol sh.a nuk e ka paguar asnjehere paditesit.
- Fill pas denoncimeve që bëri ndaj palës së paditur, babai i paditesit, (i punësuar dhe ai në Albpetrol,) në dt.25.07.2014 pushohet në mënyrë të menjehershme nga puna.
- Mbas tij pushohet dhe paditesi nga puna, ku filloi procedura në 31 gusht 2014 dhe duhet të kishte përfunduar në dt.21.11.2014, por realisht nuk u pasua me për muajt shtator-tetor-nëntor 2014, njëkohësisht, ndër muajt janar 2014 deri në 31 gusht 2014, ndaj paditesit është ushtruar një presion i madh psikologjik është krijuar një gjendje ankthi stresi personale dhe familjare dhe pasigurie nga përfaqësuesit e sektorit ku punonte, që babai tij të hiqte dorë nga denoncime publike të mbyllte gojë se do të pushoheshim familjarisht nga puna.
- Motivacioni që Albpetrol ka pretenduar në pushimin e paditesit nga puna ishte mbyllja e vendit të punës, por ky motivacion nuk është i vertetë, sepse nëpërmjet dy vendimeve është vertetuar që pas pushimit të tij nga puna u morën në punë dy jurista të tjerë që tregojnë se paditesi është pushuar nga puna qëllimisht vetëm për shkak të lidhjeve familjare që kishte me z. [REDAKTUAR] dhe denoncimeve publike në të gjithë instancat e shtetit shqiptar.
- Në vendimin e tij, KMD Tirane në hetimin dhe administrimin e akteve prane punëdhënësit Albpetrol sh.a Patos në seancën e ballafaqimit ka arritur në konkluzionin se Albpetrol sh.a Patos me vendim me nr.595, dt.21.10.2014 dhe me vendimin me nr.41, dt.27.07.2015 ka

punesuar dy juristat te tjere ne pune, pra kur mbyllet vendi i punes kemi zvogelim te numrit te juristave ne te vertete jane marr dy te tjere dhe z. [REDACTED] eshte pushuar nga puna per shkak te lidhjeve familjare me [REDACTED] dhe [REDACTED] dhe se masat e marra ndaj tij kane ardhur pas ankimit te prinderve te paditesit prane KMD Tirane.

- Ne proces u vertetua se Albpetrol sh.a Patos nuk solli asnje prove shkresore per te mbrojtur pretendimet e tij apo per te vertetuar masat qe kishte marre per te rregulluar pasojat dhe veprimet e kundraligjshme te kryera ndaj paditesit dhe familjes [REDACTED]
- Ne procesin gjyqesor Albpetrol sh.a nuk argumentoi dot ligjerisht punesimet e juristeve te marre ne pune te sapodiplomuar dhe nga jashte Albpetrolit, si para pushimit nga puna, si pas pushimit te paditesit nga puna .

GJYKATA E APELIT VLORE

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarës Iliba Bezati;

Përfaqësuesin e palës paditëse, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit dhe pranimin e plote te padise; në mungesë së palës së paditur dhe personit te trete dhe pasi shqyrtoi dhe bisedoi çështjen në tërësi;

V E R E N

Nga shqyrtimi gjyqësor i ceshtjes ka rezultuar e provuar se, paditesi [REDACTED] ka qene punemarres i te paditurit shoqeria Albpetrol sh.a, Patos, e cila me vendimin nr.516, dt.22.08.2014, ka zgjidhur kontraten e punes me paditesin [REDACTED]

Paditesi [REDACTED] i eshte drejtuar Gjykates dhe ka kerkuar demshperblimin per shkak te zgjidhjes se kontrates se punes. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e shkallës së parë Fier, me vendimin nr.62-2015-1409 (510), dt.20.04.2015 ka vendosur detyrimin e te paditurit Albpetrol sh.a, Patos te demshperbleje paditesin [REDACTED] per zgjidhje te marredhenieve te punes ne menyre te menjehershme dhe pa shkaqe te arsyeshme,per mosrespektim te afatit te njoftimit ne zgjidhjen e kontrates se punes; te procedures se zgjidhjes se kontrates se punes si dhe shperblimin per vjetersine ne pune. Ky vendim ka marrë formë të prerë me vendimin nr.1103, dt.25.10.2016 të Gjykatës së Apelit Vlore.

Paditesi [REDACTED] duke pretenduar se shkak i zgjidhjes se kontrates se tij te punes eshte diskriminimi nga i padituri Shoqeria Albpetrol sh.a, Patos per shkak te lidhjeve familjare me shtetasin [REDACTED], i eshte drejtuar Komisionerit per Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi, me vendimin nr. 164, dt. 19.11.2015, ka vendosur:

- Konstatimin e diskriminimit te shtetasit [REDACTED] per shkak te lidhjeve familjare ne formen e viktimizimit, nga ana e Shoqerise Albpetrol sh.a, Patos;
- ne referim te pikes 1, Shoqeria Albpetrol sh.a, Patos, si subjekt qe ka konsumuar sjelljen diskriminuese, te beje rikthimin e z. [REDACTED] ne vendin e meparshem te punes;
- Shoqeria Albpetrol sh.a, Patos detyrohet qe brenda 30 diteve te njoftoje Komisionerin lidhur me veprimet e ndermarra per zbatimin e ketij vendimi.

I padituri Shoqeria Albpetrol sh.a, Patos i eshte drejtuar Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane me kerkesen per konstatimin e pavlefshmerise absolute te vendimit nr.164, dt. 19.11.2015, te Komisionerit per Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tirane, me vendimin nr.80-2016-926 (934), dt.01.03.2016, ka vendosur:

- Pranimin e pjesshem te padise administrative;
- Konstatimin absolutisht te pavlefshem te veprimit administrativ, dhenia e mases "rikthimin e Z. [REDAKTUAR] ne vendin e meparshem te punes", te kryer prej pales se paditur, ne piken 2 te aktit administrativ nr. 164, dt. 19.11.2015;
- Rrezimin e padise per pjesen tjeter te saj, si te pabazuar ne ligj dhe ne prova.

Paditesi [REDAKTUAR] duke pretenduar faktin e diskriminimit ne formen e viktimizimit, per shkak te lidhjeve familjare i është drejtuar gjykatës qe te konstatoje faktin e diskriminimit dhe te detyroje te paditurin qe t'a ktheje ne vendin e meparshem te punes, si dhe t'i paguaje shperblimin e demit jopasuror qe ka pesuar nga ky fakt.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrezimin e padisë.

Cështja shqyrtohet në Gjykatën e Apelit mbi ankimin e paditesit për ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë, duke pretenduar se vendimi i Gjykatës së shkallës së parë është marrë në interpretim të gabuar të ligjit material dhe atij procedural.

Në analizë të akteve të administruara dhe të rrethanave të cështjes, gjykata e apelit cmon se, vendimit i ankimuar është vendim i drejtë, i bazuar në ligj dhe në prova dhe për rrjedhojë, duhet të lihet në fuqi.

Bazuar në nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, "*Kushdo për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e caktuar me ligj*". Pikërisht, kjo e drejtë themelore e çdo subjekti, do të gjejë zbatim dhe aplikim edhe në ligje të veçanta, të cilat parashikojnë shprehimisht thelbin e së drejtës subjektive si dhe të drejtën për ta mbrojtur atë.

Kjo e drejtë e paditësit për të kundërshtuar veprimet e palës së paditur, gjen mbështetje të plotë në nenin 36 te ligjit nr.10221, dt.04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi" në të cilin parashikohet se: "*..padia i paraqitet gjykatës kompetente nga nje prej subjekteve te parashikuara ne nenin 34 te ketij ligji jo me vone se 5 vjet nga dita qe ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo me vone se 3 vjet nga dita qe i demtuari merr dijene per kete sjellje.*

I demtuari nuk ka detyrim te njoftoje Komisionerin para se te paraqese nje padi per diskriminim ne gjykate.

Gjykata e njofton Komisionerin per paraqitjen e cdo padie per diskriminim. Gjykata mund t'i kerkoje Komisionerit, ne cdo faze te procedimit, qe te paraqese nje mendim me shkrim, rezultatet e hetimit te tij, ne qofte se eshte bere hetimi, ose cdo informacion tjeter qe ka rendesi per ceshijen.

Paditesi ka detyrim te sjelle prova ne mbeshtetje te padise, duke perdorur cdo lloj prove te ligjshme qe mund te provoje sjelljen diskriminuese.

Pasi paditesi paraqet prova, mbi te cilat bazon pretendimin e tij dhe ne baze te te cilave gjykata mund te prezumoje sjelljen diskriminuese, i padituri detyrohet te provoje se faktet nuk perbejne diskriminim sipas ketij ligji."

Në interpretim të dispozitave ligjore të cituara si më sipër, rezulton që ligjvënësi ka parashikuar në

mënyrë të posaçme se, çdokush që cënohet në të drejtat dhe interesat e tij nga një akt administrativ, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës për mbrojtjen e tyre. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës, është një e drejtë e patjetërsueshme, e pandashme dhe e padhunueshme, e cila është pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, parashikuar edhe nga neni 6 i KEDNJ-së. Kjo e drejtë, është në të njëjtën kohë, një prej parimeve bazë më të rëndësishme, e detyrueshme për t'u respektuar si nga gjykatat, ashtu dhe nga të gjitha institucionet e administratës shtetërore.

Por, realizimi i kësaj të drejte të njohur nga ligji dhe nga Kushtetuta, nuk është e pakufizuar në kohë, pasi në nenin 112 të Kodit Civil parashikohet se *"E drejta e padisë që nuk është ushtruar brenda afatit të caktuar në ligj, shuhet dhe nuk mund të realizohet me anë të gjykatës ose të organit tjetër kompetent"*.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite tregohet se parashkrimi i padisë përmban kurdoherë dy kushte ose elemente thelbësorë:

a) kalimin e një periudhe kohe të caktuar dhe

b) mosveprimin e titullarit për të ushtruar këtë të drejtë gjatë kësaj kohe. Kushti i parë përbën atë që quhet afat i parashkrimit të padisë dhe kushti tjetër konsiston në mosveprimin e titullarit të së drejtës në rastet kur ai mund dhe duhej të vepronte.

Elementi thelbësor i parashkrimit nuk është kalimi i kohës në vetvete, por është mosveprimi/pasiviteti i titullarit të së drejtës për të mbrojtur, brenda kohës së caktuar nga ligji, të drejtën e tij të cënuar ose të mohuar.

Duke iu referuar dispozitës së ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" e konkretisht nenit 36 të tij janë parashikuar dy lloj afatesh për parashkrim të padisë për mbrojtjen nga diskriminimi, e konkretisht afati 5 vjeçar, i cili lidhet me momentin e ndodhjes së faktit diskriminues dhe afati 3 vjeçar që i referohet momentit të marrjes dijeni të personit ndaj të cilit është ushtruar sjellja diskriminuese.

Referuar çështjes në shqyrtim, rezulton se paditësi në ankimin e tij ka pretenduar se gjykata e shkallës së parë ka gabuar kur ka vendosur rrezimin e padisë për shkak të parashkrimit të saj, duke parashtruar se, komunikimi zyrtar dhe marrja zyrtarisht e shkresave të Albpetrol si dhe sjellja diskriminuese, në mënyrë zyrtare i janë komunikuar në vitin 2015, duke konsideruar se momenti i marrjes dijeni është ai i formal, shkresor.

Gjykata e Apelit e gjen jo të drejtë këtë qëndrim të mbajtur nga paditësi, pasi nga rrethanat e çështjes ka rezultuar e provuar se, i padituri Shoqeria Albpetrol sh.a, Patos ka filluar procedurën për zgjidhjen e kontratës së punës me paditesin [REDAKTUAR] me shkresën nr.6414 prot, dt.08.08.2014, ku i është kërkuar ketij të fundit që të paraqitet në Drejtorinë e Burimeve Njerezore të Administratës me dt.18.08.2014, ora 10:00, për të diskutuar në lidhje me vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës. Paditësi [REDAKTUAR] ka marrë dijeni në lidhje me njoftimin për takim me punëdhënësin me dt. 14.08.2014, sikurse ka rezultuar nga nënshkrimi i tij në kopjen e ketij akti.

Nga aktet që ndodhen në dosjen gjyqësore nuk rezulton që të jete zhvilluar një takim i tillë mes paleve ndërgjyqëse dhe pavarësisht ketij fakti, Administratori i Shoqerisë Albpetrol sh.a, Patos ka marrë vendimin nr.516, dt.22.08.2014 për zgjidhjen e kontratës së punës së paditesit [REDAKTUAR]

Rezultoni se, paditesi [REDAKTUAR] ka vazhduar punen edhe pas daljes se vendimit nr.516, dt.22.08.2014 te Administratorit te Shoqerise Albpetrol sh.a, Patos, per shkak te disponimit te tij se marrredheniet e punes do te perfundonin zyrtarisht 3 muaj me pas dhe konkretisht me dt.21.11.2014.

Po keshtu, rezultoni se paditesi [REDAKTUAR] ka marre dijeni per zgjidhjen e kontrates se tij te punes me dt.03.09.2014, kur eshte thirrur nga eprori i tij i drejteperdrejte, z. [REDAKTUAR], i cili i kishte thene se i ishin zgjidhur marrredheniet e punes ne menyre te menjehershme dhe se nuk duhet te shkonte perseri ne ndermarrje.

Ne muajin tetor te vitit 2014, paditesi [REDAKTUAR] pasi ka verifikuar llogarine bankare te pages, ka konstatuar se nuk i kishte kaluar paga e muajit shtator, pra i ishte zgjidhur marrredhenia e punes ne menyre te menjehershme. Ne keto kushte, ne ndryshim nga cfare eshte pretenduar ne ankim, si moment i marrjes dijeni per zgjidhjen e marrredhënies se punës, me te drejte gjykata e shkallës se pare ka vlerësuar datën 31.10.2014.

Kryerja e veprimeve te njepasnjeshme nga ana e palës se paditur, sic jane akti i njoftimit date 14.08.2014 per zgjidhjen e marrredhënies se punës, komunikimi verbal me eprorin ne date 03.09.2014 po per zgjidhjen e marrredhënies se punës tregojne marrjen dijeni efektivisht prej paditesit qysh me date 14.08.2014 per zgjidhjen e kontrates se punës dhe dijenia per kete fakt eshte konfirmuar dhe prej veprimeve te metejshme te palës se paditur, sic eshte moskalimi i pagës ne muajin tetor.

Pra, ne rastin ne gjykim ka rezultuar i provuar fakti, se minimalisht me dt.31.10.2014, paditesi [REDAKTUAR] ka marre dijeni efektivisht per zgjidhjen e kontrates se punes, pasi ka verifikuar e konstatuar se fundmi qe prej palës se paditur nuk i ishte kaluar me paga, pra kur ka ardhur ne dijeni efektivisht per veprimin qe eshte konsideruar si sjellje diskriminuese e ushtruar ndaj tij. Pavaresisht ketij fakti, paditesi [REDAKTUAR] e ka paraqitur padine me dt.09.11.2017, pra pasi ka perfunduar afati 3-vjecar, i parashikuar ne nenin 36 te ligjit nr.10221, dt.04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi".

Paditesi pretendon se, padia eshte depozituar brenda 3 viteve te zgjidhjeve te marrredhenieve te punes, si dhe brenda 3 viteve nga marrja dijeni formalisht prej te gjitha shkresave dhe vendimeve gjyqesore te permendura me siper, qe jane pjese e dosjes gjyqesore, sepse para dates 09.11.2014 ai nuk ka patur ne dispozicion asnje akt shkresor qe formalisht ta njoftonte se i ishte zgjidhur kontrata e punës. Gjykata e Apelit cmon se, pikërisht afatin 3 vjecar, lidhur me momentin e marrjes se informacionit te duhur persa i perket sjelljes diskriminuese, ligjvënësi nuk e lidh me ndonje akt formal. Mungesa e nje njoftimi formal per përfundimin e marrredhënies se punës, përbën shkak per mosrespektim te procedurës, por kurrsesi nuk mund te pretendohet se paditesi nuk ka patur dijeni per zgjidhje te marrredhënies se punës dhe per shkakun diskriminues te pretenduar prej tij e te njohur me pas nga instancat e tjera shtetërore. Fakti qe paditesit nuk i eshte njoftuar formalisht me shkrim vendimi per zgjidhjen e kontrates se punes nuk ka asnje ndikim ne vleresimin e situates juridike te marrjes efektivisht dijeni mbi kete vendim. Mungesa e njoftimit me shkrim sjell vetem pasojen e parashikuar ne nenin 144/5 te K.Punes, pra dëmshpërblimin per mosrespektimin e procedurës perkatese te zgjidhjes se marrredhënies se punës, sikurse ka rezultuar nga permbajtja e vendimit nr.62-2015-1409 (510), dt.20.04.2015 te Gjykates se shkallës se pare Fier, por kurrsesi nuk mund te jete e barasvlefshme me mungesen e marrjes dijeni efektivisht mbi kete vendim.

Ne kuptim te nenit 36 te ligjit nr.10221, dt.04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi", marrja dijeni mbi sjelljen diskriminuese do te thote qe subjekti i demtuar efektivisht, pra realisht dhe ne fakt, te kete informacionin e nevojshem dhe te mjaftueshem, i cili te tregojte qarte se kjo sjellje ka ndodhur. Ne momentin qe subjekti ka nje informacion te ketij karakteri, ai konsiderohet se ka dijeni

per faktin qe ka ndodhur sjellja diskriminuese. pavaresisht nese jane respektuar formalitetet e parashikuara ne ligj per njoftimin.

Për sa më sipër , pretendimet e ngritura ne ankimin e pales paditëse përsa i përket tejkalimit të afatit të parashkrimit të padisë, Gjykata e Apelit i vlereson te pabazuara ne ligj e ne prova dhe si të tilla, nuk perbejne shkak per cenimin e vendimit te dhene.

Të pabazuara në prova e në ligj janë pretendimet e pales paditëse për qëndrim të njëanshëm të gjyqtarit të çështjes. Sipas paditësit, gjyqtari i çështjes ka mbajtur qëndrim favorizues ndaj palës së paditur, sepse pasi eshte pushuar familjarisht nga puna paditesi dhe gjithë familja e tij, pranë palës së paditur është punësuar nje person shumë i afërt familjar i tij i radhes se pare (motra), ndërkohë gjyqtari po gjykonte punedhenesin e familjareve te tij, kundra paditesit [REDACTED] e kundërshtim flagrant me nenin 72/5 te K.Pr.Civile. Sipas palës paditëse, ky fakt provohet me rrezimin e kërkesave të njëpasnjëshme të paditësit duke mos pranuar te sillen provat e kerkuara nga paditesi, duke mos pranuar si nderhyres dytesor babain e paditesit dhe duke dhënë një vendim të paarsyetuar.

Në të kundërt sa pretendon paditësi, asnjë provë nuk u soll prej tij për të provuar se, gjyqtari është në konflikt interesi me palën e paditur dhe asnjëherë pala paditëse nuk ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes, ndërsa vendimet e ndërmjetme të gjykatës përsa i përket lejimit të provave dhe hetimit gjyqësor si dhe përsa u përket kërkesave procedurale për ndërhyrje dytësore të babait të paditësit, [REDACTED] në këtë proces gjyqësor, gjykata e apelit i gjen në përputhje me normat procedurale civile. Ndaj rrezimit të kërkesës për ndërhyrje dytësore nuk është ushtruar ankim i vecantë, sipas nenit 194 të K.Pr.Civile, pra ky pretendim bie ne dekadencë. Lejimi i provave është bërë nga gjykata e shkallës së parë në mënyrë të kujdesshme, në respektim të nenit 12 dhe 213 të K.Pr.Civile, për të lejuar ato prova që janë të domosdoshme e që kanë lidhje me çështjen objekt gjykimi. Ndaj nuk qëndron as pretendimi tjetër i palës paditëse se vendimi është i paarsyetuar, në kushtet kur se pari, gjykata ka argumentuar të gjitha faktet e provat sipas te cilave, padia duhet të rëzohet për shkak të parashkrimit të saj dhe se dyti, kur tejkalimi i afatit të parashkrimit të padisë perben për gjykatën shkak perjashtues për zgjidhjen e çështjes në themel.

Në këto rrethana, vendimi i ankimuar duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata e Apelit, bazuar ne nenin 466/a te K.Pr. Civile,

VENDOSI

Lënen në fuqi të vendimit Nr. 546 ,datë 20.04.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.

Vlorë më 22.07.2020

ANETAR
SOKOL NGRESI

ANETAR
NAZMI TROKA

KRYESUESE
ILIBA BEZATI

